


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5513
E premte, 29 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Fabrika e Municionit dhe ajo e Baterive mbesin jashtë statutit të 'Trepçës' | FAQE 8-9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com


facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

BASHKIMI EVROPIAN DHE KORRUPSIONI NË KOSOVË | F. 11

Akademik Rexhep QOSJA



KURTI SHPREH SHQETËSIMIN PËR PAGAT E QEVERITARËVE PARA PËRFAQËSUESVE TË FMN-së | F. 5

20 MIJË BANORË I JANË SHTUAR KOSOVËS NË VITIN 2017 | F. 7

KRU 'PRISHTINA' ME PERFORMANCËN MË TË MIRË PËR VITIN 2017 | F. 10

EKONOMI

SLLOVENËT TË INTERESUAR PËR INVESTIME NË ENERGJI PËRMES RICIKLIMIT TË MBETURINAVE | F. 9

GËRXXHALIU: DËNIMI I 'ELKOS GROUP'-it, POLITIK | F. 9

SPORT

XHUDOJA IA SJELL KOSOVËS MEDALJEN E TRETË TË ARTË | F. 18

KF PRISHTINA BARAZON NDAJ FC EUROPAS | F. 19



FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI | FAQE 4-5

Nuk duhet të mungojë vullneti politik për konsensus kombëtar

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se arritja e konsensusit kombëtar për temat e mëdha kërkon përgjegjësi të madhe dhe energji pozitive politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se për të arritur këtë qëllim nuk duhet të mungojë edhe vullneti politik. Sipas tij, këtë vullnet politik ende nuk e kanë treguar drejtuesit shtetërorë. Sa i përket dialogut me Serbinë, Krasniqi ka thënë se për fazën finale të këtij procesi duhet të arrihet konsensusi në Kuvendin e Kosovës përndryshe, kështu si po ecën tani dialogu, duhet të ndërpritet. Duke folur për paralajmërimet e opozitës për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë, Krasniqi ka thënë se çështja e mocionit është e drejtë demokratike e opozitës, por ajo duhet t'i ketë numrat për ta bërë një gjë të tillë

PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE | FAQE 3

Thaçi: Vulë përfundimtare dialogut do t'ia japë Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'ia japë vulën përfundimtare procesit të dialogut me Serbinë. Kështu ka deklaruar të enjten presidenti Hashim Thaçi në një konferencë me gazetarë, në të cilën ka shprehur gatishmërinë të

raportojë para deputetëve për këtë proces. Shefi i shtetit ka thënë se tani është koha e fundit për arritjen e konsensusit politik për dialogun ndërmjet dy vendeve meqë, sipas tij, në fazën finale bisedimet do të jenë të vështira



Rekomandimi për liberalizimin e vizave, para pushimit të verës

Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije të enjten se ka marrë garanci nga Komiteti për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Punë të Brendshme në Parlamentin Evropian (LIBE), se të gjithë anëtarët e tij do të

votojnë pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Në një konferencë për medie, ajo ka thënë se rekomandimi i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën do të bëhet para pushimeve të verës | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kosova akrediton ambasadorin e saj në Çad

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Senegal, Ramadan Gashi, i ka dorëzuar letrat kredenciale tek presidenti i Republikës së Çadit, Idriss Deby Itno, duke u bërë si ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Republikën e Çadit, me rezidencë në Dakar, Senegal.

Në këtë vizitë ambasadori Gashi është shoqëruar nga drejtori për Çështje Politike, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Lulzim Mjeku. Delegacioni i Republikës së Kosovës, gjatë qëndrimit në kryeqytetin Nxhamena, është pritur edhe nga ministri i Punëve të Jashtme, Mahamat Zeni Cherif dhe drejtori i Protokollit të Shtetit,

Ossodongarti Memdingangar. Me këtë rast, ambasadori Gashi i dorëzoi kopjet e letrave kredenciale ministrit Mahamat Zeni Cherif dhe i përcolli mesazhet e zëvendëskryeministrit të parë dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Të dy palët bashkëbiseduese prekën tema me interes të përbashkët për dy shtetet.



Haziri: Dialogu pa opozitën do të dështojë



PRISHTINË, 28 QERSHOR - Nën kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë se pa opozitën dialogu me Serbinë mund të dështojë. Në një intervistë dhënë për "Radion Evropa e Lirë", ai ka thënë se ky rifillim i ri i dialogut nuk është premtues shumë për faktin se nuk arriten të realizohen tri kriteret udhëheqëse të bisedimeve që LDK-ja i parashtrroi: ndërtimi i një konsensusi sa

më të gjerë politik në Kuvend, i cili do të dilte nga një debat i partive politike, një proces i cili do të jetë i hapur dhe transparent për qytetarët dhe në mënyrë që një marrëveshje obliguese që pritet të dalë, ta ketë mbështetjen e shumicës politike në Republikën e Kosovës. "Natyrisht se pa LDK-në dhe pa forcat politike në Kuvendin e Republikës ky proces nuk mund të jetë i suksesshëm. Kështu që, edhe më tutje janë në fuqi këto kriteret

që Kryesia e LDK-së në mbledhjen e 24 majit i ka konfirmuar dhe i ka bërë të qarta edhe për institucionet vendore, edhe për partitë që qeverisin, edhe për presidentin, edhe për shtetet e Quint-it dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, por që këto kriteret në këtë fazë nuk janë përmbyllur dhe LDK-ja rri në kampin politik, duke e përcjellë dhe duke e monitoruar këtë proces si parti politike opozitare vetëm", ka thënë Haziri.

Hapja e negociatave, Meta thirrje për përgjegjësi dhe bashkëpunim



TIRANË, 28 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka reaguar pas vendimit për shtyrjen e hapjes së negociatave në qershor të vitit të ardhshëm, duke u bërë ftesë të gjitha palëve politike për përqendrim, përgjegjësi dhe bashkëpunim, për të kaluar, siç thotë ai, provimin e qershorit të ardhshëm. Presidenti Meta ka thënë se konkluzionet e Këshillit të BE-së

mbi negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë duhen mirëpritur. "Ne të gjithë duhet ta vlerësojmë dhe çmojmë vullnetin pozitiv me të cilin si Komisioni Evropian ashtu edhe të gjitha vendet anëtare, e mirëpresin procesin e integritetit të Shqipërisë dhe gjithë rajonit në BE. Kjo qasje duhet të na nxisë për një lexim të drejtë dhe realist të sfidave serioze që kemi

përpara, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Një vit kalon shpejt, ashtu si nga dje kaloi një ditë. Provimi ynë i qershorit të ardhshëm do të jetë shumë i vështirë e kërkues pasi edhe vetë Bashkimi Evropian do ta ketë provimin e tij zgjedhor në të njëjtën kohë. Ndaj, i ftoj të gjithë për përqendrim, përgjegjësi dhe bashkëpunim", ka thënë Meta.

Pajaziti e Pantina në Gjermani, kërkojnë mbështetje për vizat

BERLIN, 28 QERSHOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Zenun Pajaziti dhe Shqipe Pantina, po qëndrojnë për vizitë treditore në Gjermani, me ftesë të Ambasadës dhe Qeverisë gjermane. Takimet në Bundestag

kanë filluar me deputetë nga Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Ligje, Grupi i Miqësisë me vendet e Evropës Juglindore, si dhe me fondacione dhe shoqata të ndryshme.

Deputetët janë pritur nga ministri për Çështjet Evropiane, Michael Roth. Në të gjitha takimet në fokus ishte mbështetja për Kosovën në proceset integruuese, veçanërisht liberalizimi i vizave.



Numër i vogël i serbëve në festën e Vidovdanit

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Qindra qytetarë serbë kanë shënuar të enjten në Gazimestan Ditën e ShënVidit, të njohur si Vidovdan. Sikurse edhe në vitet e kaluara, ceremonia fetare ortodokse, e njohur si rituali i "këngëve të vajit", është mbajtur pranë mon-

umentit të Betejës së Kosovës. Ceremonia ka shkuar qetë, derisa për mbarëvajtjen e rendit Policia e Kosovës kishte ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme. Në këtë ceremoni qytetarët serbë mbanin flamujt e Serbisë dhe brohoritnin "Kosova

është zemra e Serbisë". Në këtë ceremoni ka qenë paraparë të jetë edhe ministri i Mbrojtjes së Serbisë, Aleksandër Vulin, mirëpo autoritetet shtetërore të Kosovës nuk i kanë dhënë leje të hyjë në Kosovë për shkak të deklaratave nacionaliste.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për medie

Thaçi: Vulë përfundimtare dialogut do t'ia japë Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Republikës së Kosovës do t'ia japë vulën përfundimtare procesit të dialogut me Serbinë. Kështu ka deklaruar të enjten presidenti Hashim Thaçi në një konferencë me gazetarë, në të cilën ka shprehur gatishmërinë të raportojë para deputetëve për këtë proces. Shefi i shtetit ka thënë se tani është koha e fundit për arritjen e konsensusit politik për dialogun ndërmjet dy vendeve meqë, sipas tij, në fazën finale bisedimet do të jenë të vështira



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Presidenti Hashim Thaçi ka thënë të enjten se është koha e fundit për arritjen e konsensusit politik për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në një konferencë me gazetarë ai e ka quajtur inkurajues faktin që partitë politike janë duke folur dhe organizuar tryeza për ta diskutuar formën dhe modalitetet e përfshirjes në procesin e dialogut. "Partitë politike të koalicionit qeverisës dhe ato opozitare janë duke e zhvilluar një dialog të brendshëm në tryezat e tyre politike që kanë zhvilluar këto ditë dhe besoj se janë në fazën përfundimtare të marrjes së një vendimi apo drejtimi adekuat për mënyrën dhe modalitetet se si do të përfshihen në këtë proces, në përgjegjësinë më të lartë, por edhe për marrjen e kredive të rezultatit historike që mund të ndodhë. Është inkurajues fakti se partitë politike janë duke folur dhe organizuar tryeza për t'i diskutuar formën dhe modalitetet për përfshirje në këtë proces. Të gjitha partitë politike në Kosovë janë në favor të dialogut, ndërsa për modalitetet do të diskutohet në ditët dhe javët e ardhshme. Është qenësore që konsensusi sa më i gjerë për dialog të arrihet sa më shpejt, pasi që koha është duke ecur dhe nuk mund të ndalemi në këtë angazhim. Nuk kemi kohë për të humbur për ekzibicione dhe për debate të kota", ka

deklaruar Thaçi. Shefi i shtetit ka bërë me dije se në fazën finale bisedimet do të jenë të rënda dhe të vështira. Por, sipas Thaçit, tanimë beteja me Serbinë zhvillohet në tavolinën e Brukselit dhe jo në studiot televizive në Prishtinë apo në Beograd. "Takimi i 24 qershorit në Bruksel me presidentin Aleksandër Vuçiq shënon fillimin e fazës përfundimtare të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë fazë synojmë arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërisht e ndërkombëtarisht të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, për ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për njohjen reciproke. Ka më shumë se dy dekada që Kosova ka kërkuar dialog si mjeti i vetëm për t'i zgjidhur kontestet e hapura në konfliktin me Serbinë. Gjatë tërë këtij procesi Kosova ka qenë konstruktive dhe e hapur për çdo takim dhe iniciativë për ta realizuar aspiratën e qytetarëve tanë për jetë më të mirë. Bisedimet në këtë fazë finale pres të jenë të rënda dhe të vështira, por tanimë të gjithë duhet kuptuar se beteja me Serbinë zhvillohet në tavolinën e Brukselit dhe jo në mes vete në studiot televizive në Prishtinë apo në Beograd", është shprehur Thaçi, duke shtuar se faza finale e dialogut do të jetë transparente. Ai është shprehur i gatshëm të raportojë para deputetëve për këtë proces duke thënë se vulën përfundimtare dialogut me Serbinë

do t'ia japë Kuvendi i Republikës së Kosovës. "Prandaj si president i Republikës së Kosovës jam i gatshëm t'i adresohem për raportim Kuvendit të Kosovës për t'i informuar deputetët dhe qytetarët për këtë fazë përfundimtare të dialogut. Në fund të fundit, marrëveshja do të dërgohet për ratifikim në Kuvendin e Kosovës për ta marrë vulën e miratimit nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit. Vulën përfundimtare dialogut do t'ia japë Kuvendi i Kosovës", ka theksuar Thaçi.

Ai ka treguar se në takimin e fundit në Bruksel nuk është diskutuar asgjë substanciale, por është diskutuar më tepër aspekti teknik, periudhat kohore, dhe modaliteti i kornizës së marrëveshjes përfundimtare. "Në takimin 24

qershorit është folur vetëm për kornizën e marrëveshjes përfundimtare dhe asgjë më tepër. Edhe në këtë takim kemi qenë bashkëpunues në kërkimin e modaliteteve dhe opsioneve për atë se çfarë është e mundur të arrihet në këtë proces, por edhe për të parë se çfarë është e pamundur të pritët në këtë fazë përfundimtare të dialogut. Presim ftesën e përfaqësueses Mogherini për takimin e ardhshëm që do të ndodhë shpejt. Ky ishte vetëm takimi i parë, dhe në javët dhe muajt e ardhshëm në takimet e tjera do të diskutohet dhe negociohet substanca e marrëveshjes përfundimtare", ka thënë Thaçi, duke shtuar se konflikti shekullor në mes të Kosovës dhe Serbisë pritët të përmyllet me marrëveshjen e pajtimit dhe njohjes

reciproke. "Arritja e marrëveshjes me Serbinë është e domosdoshme për synimin tonë që të bëhemi shtet anëtar i OKB-së, për ta përsheptuar procesin e integritetit në BE dhe në paktin NATO. Në fund të procesit duhet të ndodhë njohja reciproke, përndryshe negociatat do të ishin krejt të pakuptimta. Kjo është një mundësi të cilën ne nuk mund dhe nuk guxojmë ta humbim. Dua t'i siguroj qytetarët e Kosovës se procesi do të jetë transparent, i përgjegjshëm, do të udhëhiqet në mënyrë institucionale si dhe do ta mbroj interesin e vendit ashtu siç kam bërë gjithë jetën time", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti ka theksuar se bisedimet e tij me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i zhvillon në bazë të mandatit që ka me Kushtetutën e Kosovës.

Delegacioni i Kuvendit po merr pjesë në seminarin Rose Roth të AP të NATO-s

SHKUP, 28 QERSHOR (ER) - Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i kryesuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit, po merr pjesë në seminarin Rose Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili po mbahet në

Kuvendin e Maqedonisë. Në këtë seminar po trajtohen tema aktuale për Ballkanin Perëndimor, siç janë: forcimi i sundimit të ligjit, marrëdhëniet e mira ndërfqinjësore dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor, kriza e migracionit dhe rrugët e Ballkanit. Ky seminar do t'i vazhdojë

punimet edhe sot (e premte), ku do të diskutohen temat: aspiratat e NATO-s në Ballkan dhe ecja përpara, reformat në mbrojtje dhe siguri, gjendja e medieve në Ballkanin Perëndimor dhe ndikimi i dezinformimit dhe keqinformimit në krijimin e opinionit publik, marrëdhëniet ndëretnike në Ballkanin Perëndimor etj.



Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

Nuk duhet të mungojë vullneti politik për kon

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se arritja e konsensusit kombëtar për temat e mëdha kërkon përgjegjësi të madhe dhe energji pozitive politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se për të arritur këtë qëllim nuk duhet të mungojë edhe vullneti politik. Sipas tij, këtë vullnet politik ende nuk e kanë treguar drejtuesit shtetërorë. Sa i përket dialogut me Serbinë, Krasniqi ka thënë se për fazën finale të këtij procesi duhet të arrihet konsensusi në Kuvendin e Kosovës përndryshe, kështu si po ecën tani dialogu, duhet të ndërpritet. Duke folur për paralajmërimet e opozitës për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë, Krasniqi ka thënë se çështja e mocionit është e drejtë demokratike e opozitës, por ajo duhet t'i ketë numrat për të bërë një gjë të tillë



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka ftuar subjektet politike t'i vazhdojnë përpjekjet për të gjetur konsensus kombëtar rreth temave të mëdha për vendin. Ai ka thënë se për të arritur këtë qëllim duhet energji pozitive dhe nuk duhet të mungojë as vullneti politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka deklaruar se këtë vullnet politik ende nuk e ka parë tek udhëheqësit shtetërorë. "Konsensuset në përgjithësi, ato kombëtare në veçanti, sidomos aty ku ka animozitet në mes të partive politike, nuk arrihen

lehtë dhe kërkojnë përgjegjësi të madhe e energji pozitive politike, intelektuale e kombëtare për t'u arritur. Iniciativat për ta krijuar konsensusin kombëtar duhet të vazhdojnë, por edhe nuk duhet të mungojë vullneti politik. Nuk e di nëse drejtuesit e shtetit kanë vullnet politik për ta krijuar konsensusin kombëtar për bisedimet politike me Serbinë?! Atë vullnet deri më tani nuk e kam parë", ka thënë Krasniqi.

Sa i përket fazës finale të dialogut për Serbinë, Krasniqi ka thënë se për këtë çështje duhet të arrihet konsensus kombëtar në Kuvendin e Kosovës. Sipas tij, nëse për këtë çështje nuk arrihet pajtueshmëri mes subjekteve politike, atëherë bisedimet duhet të ndërpritin. "Kosova

duhet të marrë frymë. Mënyra se si është biseduar e si po tentohet të bisedohet, urgjentisht duhet të ndërpritet dhe të arrihet konsensusi kombëtar në Kuvendin e Kosovës. Përndryshe, pasojat mund të jenë të paparashikueshme për të ardhmen e vendit. Kështu si është tani, ndërprerja e bisedimeve është puna më e mençur e mundshme. Më mirë ngrirja e raporteve sesa krijimi i hapësirës për konflikt të ri", është shprehur Krasniqi.

Në këtë intervistë ish-kryetari i Kuvendit ka folur edhe për përpjekjet e opozitës për ta rrëzuar Qeverinë. Krasniqi ka thënë se, përveç vullnetit të opozitës për mocion mosbesimi, duhen edhe numrat në Kuvend që, sipas tij, kjo opozitë nuk i ka. "Çështja e

mocionit është e drejtë demokratike e opozitës, por ajo duhet t'i ketë numrat për ta bërë mocionin. Vetëm vullneti për ta rrëzuar Qeverinë, edhe opozita e di se nuk mjafton. Edhe po të krijohej mundësia për të shkuar në zgjedhje, zgjedhjet do të ishin më shumë se gjysmake, pasi do të vazhdonte të ishte i njëjti kryetar i vendit, i cili e ka atë pozitë edhe në sajë të partisë më të madhe opozitare. Këtu natyrisht shtrihet pyetja cili do të ishte funksionimi i institucioneve kryesore të shtetit. Përpjekja e opozitës kështu si është e çorganizuar do të ishte përpjekje e Sizifit", ka deklaruar Krasniqi.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, subjektet politike deri më tani kanë mbajtur disa tryeza politike për

të arritur një konsensus kombëtar për temat e mëdha, por deri më tani nuk ka ndonjë rezultat. Cili është vlerësimi juaj për këtë iniciativë?

Krasniqi: Konsensuset në përgjithësi dhe ato kombëtare në veçanti, sidomos aty ku ka animozitet në mes të partive politike, nuk arrihen lehtë dhe kërkojnë përgjegjësi të madhe e energji pozitive politike, intelektuale e kombëtare për t'u arritur. Iniciativat për të krijuar konsensusin kombëtar duhet të vazhdojnë, por edhe nuk duhet të mungojë vullneti politik. Nuk e di nëse drejtuesit e shtetit kanë vullnet politik për të krijuar konsensusin kombëtar për bisedimet politike me Serbinë?! Atë vullnet deri më tani nuk e kam parë.

sensus kombëtar

dialogut final, Kosova duhet të marrë frymë. Mënyra se si është biseduar e si po tentohet të bisedohet, urgjentisht duhet të ndërpritet dhe të arrihet konsensusi kombëtar në Kuvendin e Kosovës. Përndryshe, pasojat mund të jenë të paparashikueshme për të ardhmen e vendit. Kështu si është tani, ndërprerja e bisedimeve është puna më e mençur e mundshme. Më mirë ngrirja e raporteve sesa krijimi i hapësirës për konflikt të ri.

"Epoka e re": Opozita ka kundërshtuar idenë që presidenti i vendit ta udhëheqë këtë fazë të dialogut. Nëse jo z. Thaçi, kush duhet ta udhëheqë delegacionin e Kosovës në këto bisedime?

Krasniqi: Deri tani bisedimet i ka udhëhequr Qeveria, por edhe kjo vetëm pasi të krijohet konsensusi kombëtar i partive politike parlamentare. Kuvendi është organi më i lartë i shtetit dhe Kuvendi nuk e ka mandatar Thaçin që t'i udhëheqë ato bisedime. Shikuar me paanësi, ato bisedime që po zhvillohen në Bruksel janë ilegale. Ato bisedime mund të mbështeten vetëm nga ndonjë zëdhënës i kryetarit në mediet tona të shumta.

"Epoka e re": Sa jeni i kënaqur me këtë Qeveri?

Krasniqi: Partia ime është pjesë e Qeverisë. Qeverisjen le ta vlerësojnë shoqëria dhe qytetarët e Kosovës. Ata janë sovran. Vlerësimi im nuk do të dukej serioz e as i besueshëm.

"Epoka e re": Subjektet politike opozitare vazhdimisht po e kërcënojnë Qeverinë me mocion mosbesimi për ta hapur rrugën për zgjedhje të reja, por deri më tani nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim. Si e keni parë këtë përpjekje të tyre dhe a mund ta rrezikojë kjo opozitë Qeverinë?

Krasniqi: Çështja e mocionit është e drejtë demokratike e opozitës, por ajo duhet t'i ketë numrat për ta bërë mocionin. Vetëm vullneti për ta rrezuar Qeverinë, edhe opozita e di se nuk mjafton. Edhe po të krijohet mundësia për të shkuar në zgjedhje, zgjedhjet do të ishin më shumë se gjysmake, pasi do të vazhdonte të ishte i njëjti kryetar i vendit, i cili e ka atë pozitë edhe në saje të partisë më të madhe opozitare. Këtu natyrshëm shtrohet pyetja cili do të ishte funksionimi i institucioneve kryesore të shtetit. Përpjekja e opozitës kështu si është e çorganizuar do të ishte përpjekje e Sizifit.

"Epoka e re": Temat për të cilat po kërkohet konsensusi kombëtar janë dialogu me Serbinë, integrimet evropiane, formimi i ushtrisë dhe disa tema të tjera. Sa është jetik për vendin konsensusi për këto çështje?

Krasniqi: Mendoj konsensusi duhet të arrihet për bisedimet me Serbinë, për asociacionin e për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë e Vuçiqit, e cila nuk duket se është duke e kërkuar normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

"Epoka e re": Si më urgjente po shihet arritja e një konsensusi kombëtar për fazën finale të dialogut me Serbinë. Si duhet të paraqitet Kosova në këtë fazë të procesit?

Krasniqi: Sa i përket çështjes së



Kosova, pjesë e Fondit Global të Mjedisit

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Në margjinat e Asamblesë së Gjashtë të Fondit Global të Mjedisit (GEF), e cila po mbahet në Da Nang të Vietnamit, ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në emër të Republikës së Kosovës mbajti një fjalë rasti para homologëve të vet dhe përfaqësuesve të 183 shteteve anëtare. Ministria Reshitaj ka shprehur

mirënjohjen e saj dhe të Kosovës për shtetin e Vietnamit, mikpritësin e këtij takimi, që ka përfshirë Kosovën në Asamblesë e Gjashtë të Global Environment Facility (GEF) dhe i ka dhënë mundësinë të jetë përkrah dhe e barabartë me shtetet e tjera pjesëmarrëse. "Përfshirja e Kosovës në këtë asamble, pavarësisht se Kosova nuk është pjesë e UN-it dhe

nënshkruese e konventave ndërkombëtare që lidhen me mjedisin, e rrumbullakon punën tonë, na ndihmon në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, që është një shqetësim yni i përbashkët, njëkohësisht na angazhon në kuadër të procesit të integritimit evropian për hapa konkretë për përmirësimin e standardeve", ka thënë ministria Reshitaj.



Kurti shpreh shqetësimin për pagat e qeveritarëve para përfaqësuesve të FMN-së

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Përfaqësuesit e FMN-së në Kosovë, Ruud Veremulen dhe Selim Thaçi, janë takuar të enjten me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe nënkryetarin e kësaj lëvizje, Besnik Bislimi. Sipas një njoftimi të Lëvizjes Vetëvendosje, me për-

faqësuesit e FMN-së është diskutuar shqetësimi për rreziqet fiskale që nuk përmbushin planifikimin buxhetor për të hyrat në këtë vit si dhe për ndikimin buxhetor afatmesëm dhe afatgjatë të një sërë vendimesh qeveritare si në paga, po ashtu edhe në politika sociale

që, sipas LV-së, më shumë janë iniciativa të fragmentarizuar që nuk ndikojnë në uljen e varfërisë në Republikën e Kosovës. Po ashtu, përfaqësuesit e FMN-së njoftuan edhe për angazhimet e tyre aktualisht dhe për vizitën e ardhshme që do ta kenë në Republikën e Kosovës.

Gjenerali amerikan interesohet për të arriturat e FSK-së



FERIZAJ, 28 QERSHOR (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, së bashku me komandanten e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, gjeneralbrigade Irfete Spahiu, në Kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj kanë pritur në vizitë komandantin e Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate për Evropë në Napoli, admiralin James G. Foogo, i cili shoqërohej nga komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Cuoci. Në takimin e përbashkët të gjeneral Ramës, gjeneral Spahiu dhe admiralit Foggo u bisedua

për misionin, detyrat dhe të arriturat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për zhvillimin dhe profesionalizimin, bashkëpunimet me institucionet e tjera partnere në rajon dhe me partnerët strategjikë. Në këtë takim është biseduar edhe për objektivat për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së në të ardhmen si një institucion i të gjithë qytetarëve. Gjenerali amerikan u njoftua edhe për misionin dhe detyrat e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes si institucion i cili trajnon, shkollon dhe stërvit pjesëtarët e FSK-së për shërbim në detyra specifike në njësitë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Vazhdon partneriteti i FSK-së me Gardën Kombëtare të Ajovës

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, kanë pritur të enjten në takime të ndara komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjeneralmajorin Timothy Orr. Ministri Berisha dhe gjeneralmajori Timothy Orr kanë biseduar për marrëdhëniet dhe partner-

itetin e suksesshëm ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës.

Berisha ka vlerësuar lart angazhimin konkret të gjeneral Orrit dhe Gardës Kombëtare të Ajovës për mbështetjen e vazhdueshme që po ofron për FSK-në, sidomos për realizimin në tërësi të planit të aktiviteteve të përbashkëta vjetore, qoftë të ushtrimeve, trajnimeve dhe shkollimeve si dhe shkëmbimeve të tjera që FSK-ja dhe

garda e Ajovës zhvillojnë për çdo vit.

Gjithashtu, edhe në takimin e gjenerallejtënant Rrahman Ramës dhe gjeneralmajor Timothy Orr u bisedua mbi sukseset e bashkëpunimit intensiv në mes të FSK-së dhe Gardës Kombëtare të Ajovës, si dhe u diskutua për objektivat për avancimin e këtij bashkëpunimi me zotimin për një koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm edhe në të ardhmen.



Policia në Gjakovë për gjashtë muaj shqiptoi 3 135 tiketa të gjobave



EPOKA E RE Qendresa RAMA

GJAKOVË, 28 QERSHOR - Komandanti i Stacionit Policor në Gjakovë, Kristë Gjokaj, ka bërë me dije se ligji i ri ka krijuar progres në përmirësimin e gjendjes në trafik në këtë komunë. "Në muajt janar-qershor janë shqiptuar 3 135 tiketa të gjobave", ka thënë Gjokaj të enjten në mbledhjen e shtatë të

rregullt të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Në këtë mbledhje Gjokaj ka dhënë informata mbi gjendjen e sigurisë në komunën e Gjakovës për periudhën e parë gjashtëmuajore të këtij viti. Ai ka thënë se situata e sigurisë në Gjakovë është duke u përmirësuar për çdo vit. "Situata paraqitet e qetë", ka thënë ai. Gjokaj ka bërë me dije se gjatë këtyre gjashtë muajve në

Komunën e Gjakovës kanë ndodhur dy vrasje të cilësuar si të izoluar, dy tentim-vrasje, një rast i vetëvrasjes si dhe pesë raste të tjera janë konstatuar si hetime të vdekjes. Komandanti Kristë Gjokaj ka folur edhe për angazhimin policor në luftimin ndaj dukurisë së drogës, ku ka pohuar se gjatë këtyre muajve janë identifikuar 31 raste të posedimit të drogës dhe janë arrestuar 35 persona.

Bruto Produkti në Kosovë shënon rritje

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin mbi Bruto Produktin Vendor" (BPV) për tremujorin e parë 2018, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante. Sipas këtij raporti, BPV-ja shënon rritje reale për 3.5 për qind në TM1 2018, krahasuar me TM1 2017.

Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 10.8 për qind,

industria përpunuese 4.8 për qind, transporti dhe magazinimi 6 për qind, tregtia me shumicë dhe pakicë 5.2 për qind, afarizmi me pasuri të patundshme 1.8 për qind, hotelet dhe restorantet 1 për qind, bujqësia, gjuetia, pylltaria 0.7 për qind, administrimi publik 2.6 për qind, ndërtimtaria 9.9 për qind dhe furnizimi me energji elektrike, ujë dhe trajtim të mbeturinave 2.6 për qind.

Ndërsa rënie reale kishte në të dhënat e industrisë nxjerrëse (-12. për qind). BPV-ja, sipas qas-

jes së shpenzimeve, ka pasur rritje në TM1 2018, krahasuar me periudhën e vitit paraprak (TM1 2017) në: eksportin e mallrave dhe shërbimeve (16.2 për qind), formimin e bruto-kapitalit (10 për qind), importin e mallrave dhe shërbimeve (7.8 për qind), shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (5.2 për qind) dhe shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe institucionet jopërfutuese, shërbimet e ekonomive shtëpiake (IJPShEsh) (1.4 për qind).



Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka mbajtur konferencë për medie

Rekomandimi për liberalizimin e vizave, para pushimit të verës

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije të enjten se ka marrë garanci nga Komiteti për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Punë të Brendshme në Parlamentin Evropian (LIBE), se të gjithë anëtarët e tij do të votojnë për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në një konferencë për medie ajo ka thënë se rekomandimi i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën do të bëhet para pushimeve të verës

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË 28 QERSHOR - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se rekomandimi i Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën do të bëhet para pushimeve të verës. Në një konferencë për medie të enjten, ajo është shprehur e bindur se rekomandimi i KE-së do të jetë pozitiv për Kosovën. "Rekomandimi pritet të dalë në ditët e fundit të qershorit apo ditët e para të korrikut. Pra, rekomandimi i Komisionit Evropian do të jetë para pushimit të verës, pastaj vjen edhe miratimi. Nëse këta hapa shkojnë kështu, pastaj do të fillojë dialogu pas pushimeve, në muajin shtator. Asnjëherë nuk është përmendur shtyrja e rekomandimit për shkak të zgjedhjeve në Parlamentin Evropian. Të gjithë janë të

interesuar që ky proces të përfundojë para zgjedhjeve", ka thënë Hoxha.

Ajo ka treguar për vizitën e fundit që ka pasur në Bruksel, duke thënë se ka marrë përkrahje unanime për këtë proces. "Kam pasur takim me sekretarin e shtetit të Belgjikës për migracion dhe azil, të cilin e kam njoftuar që numri i azilkërkuësve ka rënë dukshëm dhe që qytetarët e Kosovës nuk do ta keqpërdorin liberalizimin e vizave", ka theksuar Hoxha. Ajo ka shprehur optimizëm se procesi i liberalizimit do të përfundojë deri në fund të vitit 2018.

Hoxha ka bërë me dije se ka marrë garanci nga Komiteti për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Punë të Brendshme në Parlamentin Evropian (LIBE), se të gjithë anëtarët e saj do të votojnë pro liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Sipas saj, Kosova i ka përm-

bushur kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian (BE), megjithatë Hoxha ka theksuar se edhe pas liberalizimit Kosova do ta vazhdojë luftën kundër krimit dhe korrupsionit. "Kam pasur takime edhe me eurodeputetë. Hapi i parë është rekomandimi i komisionit dhe miratimi në komitetin LIBE. I njoftova se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret për këtë proces. Sigurova eurodeputetët se Kosova do ta vazhdojë luftën kundër krimit dhe korrupsionit edhe pas liberalizimit. Do t'i vazhdojmë reformat", është shprehur ajo. Ministrja Hoxha ka treguar se eurodeputetët do të votojnë pro liberalizimit me shumicë absolute. "Ka pasur deputetë nga vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe e kanë pranuar liberalizimin e vizave. Do të ketë transparencë të plotë në këtë proces", ka thënë ajo. Në këtë konferencë ministrja



Hoxha ka folur edhe për implementimin e MSA-së nga institucionet e Kosovës. Ajo ka treguar se secilit institucion personalisht i ka dërguar letër me detyrat të cilat ata i kanë të papërfunduara, por edhe për detyrat të cilat i presin në tremujorin e ardhshëm. "Edhe MSA-në e shohim se ka ecur me një trend pozitiv. Nëse e krahasojmë me vitin 2016, ku kemi pasur një implementim apo zbatim të përgjithshëm prej 58-

përqindësh, në vitin 2017 kemi arritur zbatim prej 63.6-përqindësh. Edhe kjo nuk mjafton, por ne synojmë që në vitin 2019 të kemi një trend edhe më të lartë të zbatimit të MSA-së", ka vlerësuar Hoxha. Ministrja ka deklaruar se është përsheptuar zbatimi i Agjendës së Reformave Evropiane (ERA). "Nëse vazhdojmë me këtë ritëm, atëherë deri në muajin shtator mund ta zbatojmë plotësisht ERA-n", ka thënë Hoxha.



20 mijë banorë i janë shtuar Kosovës në vitin 2017

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Vlerësimin e popullsisë" për vitin 2017. Vlerësimi i numrit të popullsisë është domosdoshmëri, praktikë dhe standard, që kërkohet të bëhet

çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi, për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (periudhë dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, një komune a një vendbanimi.

Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë (demografinë)

janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash. Sidomos, analiza për çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara: komunale, kombëtare dhe rajonale. Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimin dhe

çështjeve të tjera socio-ekonomike. Gjatë vitit 2017 popullsia e Kosovës pati një rritje natyrore për 20 406 ose, shprehur në përqindje, është rritur për 1.13 për qind. Gjatë vitit 2017 është vlerësuar se 9 376 persona kanë ndërruar vendbanimin (komunën) e tyre.

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2017 ishte (-5 431 banorë). Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017, u rrit për 14 975 banorë, ose 0.84 për qind. Popullsia në Kosovë për vitin 2017 vlerësohet të jetë 1 798 506 banorë rezidentë.

Fabrika e Municionit dhe ajo e Baterive mbesin jashtë statutit të 'Trepçës'



Ndonëse Sindikata e Punëtorëve të Trepçës ka kërkuar nga institucionet vendore që të hidhet poshtë draftstatuti për ndërmarrjen "Trepça" sh. a., i propozuar nga bordi i kësaj ndërmarrje, me arsyetimin se ky draftstatut nuk është në interesin e "Trepçës", gazeta "Epoka e re" ka siguruar draftstatutin e Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës, i cili i është dërguar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ku në nenin 6 nuk figurojnë Fabrika e Municionit, Fabrika e Baterive dhe ajo e Proceseve dhe Pajimeve. Kështu që këto tri fabrika kanë mbetur jashtë statutit të "Trepçës"

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINE, 28 QERSHOR - Ndërmarrja "Trepça", e cila në të kaluarën ishte promotore e zhvillimit ekonomike, tani në saje të rrethanave politike vazhdon të operojë me humbje. Debat i fundit për draftstatutin e Ndërmarrjes "Trepça" ka ngjallur reagime të shumta.

Sindikata e Pavarur e Minatorëve ka kërkuar që çështjet sociale të hyjnë në draftstatutin e Ndërmarrjes "Trepça", në anën tjetër përfaqësues të Bordit Mbikëqyrës të kësaj ndërmarrje kanë pohuar se çështjet sociale duhet të zgjidhen me Ligj të veçantë për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes "Trepça". Sipas informacioneve që ka siguruar gazeta "Epoka e re", në

Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik janë dorëzuar dy versione të draftstatutit të "Trepça" sh. a. Mirëpo, edhe përkundër kërkesave të Sindikatës së Pavarur të Minatorëve lidhur me çështjet sociale, në draftstatutin që ka dorëzuar kjo sindikatë nuk janë përfshirë të gjitha njësitë e "Trepçës". Gazeta "Epoka e re" ka siguruar një kopje të draftstatutit të ndër-



marrjes "Trepça sh. a.", që është dorëzuar nga Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Në këtë draftstatut vërehet se janë lënë anash shumë njësi të ndërmarrjes "Trepça" dhe çështjet sociale. Sipas statutit të Sindikatës së Minatorëve, neni 6, themeluesit, pika 3.1, 3.2, 3.3, krijohen njësitë: Minierat me Flotacion Trepça - Stantërg, Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë, si dhe Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviq. Kurse në pikën 4 të nenit 6 thuhet se: "Bazuar në studimin e fizibilitetit dhe arsyeshmërinë ekonomike e financiare, në përbërje të Trepça sh. a. formohen edhe këto njësi biznesore": Metalurgjia e Plumbit, Metalurgjia e Zinkut, Industria Kimike. Por, në bazë të draftstatutit të Sindikatës njësitë dhe asetet të cilat janë lënë anash nga draftstatuti i sindikatës janë: Fabrika e Proceseve dhe Pajimeve, Fabrika e Baterive dhe Fabrika e Municionit. Të gjitha njësitë dhe asetet e lartcekura kanë mbetur jashtë draftstatutit të propozuar nga Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Trepçës. Ndërkaq kryetari i Sindikatës së Trepçës, Shyqri Sadiku, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se të gjitha asetet e "Trepçës" janë të përfshira në draftstatutin e tyre. I pyetur nëse e kanë përfshirë

edhe Fabrikën e Municionit në këtë draftstatut, Sadiku është përgjigjur: "Po, edhe Fabrikën e Municionit e kemi përfshirë, e cila është në Skenderaj". Ai ka thënë se asnjë aset të ndërmarrjes nuk e kanë përjashtuar. "Të gjitha asetet duhet të hyjnë në statut. Kemi kërkuar të formohet një komision nga Qeveria dhe nga njerëzit që e njohin 'Trepçën', pa përjashtuar akademikët e shkencave në Kosovë. Ne i kemi përfshirë 27 asetet. Pra, nuk i përjashtojmë asetet dhe punëtorët të cilët kanë dhënë kontribut. Pos njësiteve biznesore që janë miniera e Stantërgut, e Artanës dhe e Kishnicës, përjashtuar këtu minierën e veriut që nuk ka qasje bordi", ka thënë Sadiku. Ai ka bërë me dije se kanë kërkuar që të ndryshohet Ligji i "Trepçës" pasi, sipas tij, edhe draftstatuti i formuar nga bordi i kësaj ndërmarrje është politik. "Ne kemi kërkuar që Ligji për 'Trepçën' të ndryshohet. Bordi i 'Trepçës' atë draftstatut e ka marrë 'copy past'. Prandaj, kërkojmë që ai draftstatut të kthehet në pikën zero, kurse çështjet sociale të zgjidhen me ligj", ka thënë Sadiku. Ndërkaq sa i përket protestës së paralajmëruar, ai ka thënë se do të organizohet protestë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe për interesin e "Trepçës". "Ne kemi paralaj-



jmëruar protestë për çështje sociale dhe për interesin e 'Trepçës' pasi, në bazë të statutit, janë të rrezikuara çështjet sociale, vendburimet e 'Trepçës', asetet e saj, por edhe

zonat që janë në interes. Bordi në draftstatut nuk ka përfshirë asnjë aset. Kemi kërkuar që me një nen të veçantë të hyjnë në statut të gjitha asetet", ka thënë Sadiku.

Syla: Çështjet sociale duhet të zgjidhen me ligj të veçantë

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes "Trepça", Ardian Syla, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ka propozuar që çështjet sociale të zgjidhen me ligj të veçantë për të gjithë punëtorët e "Trepçës". "Çështjet sociale duhet të zgjidhen përmes formave të duhura dhe institucioneve qeveritare, prandaj Bordi Mbikëqyrës ka propozuar që çështjet sociale të zgjidhen me ligj të veçantë për të gjithë punëtorët e 'Trepçës'. Për këtë iniciativë janë pajtuar të gjithë anëtarët e Komisionit Parlamentar të Zhvillimit Ekonomik, ku për momentin jemi duke diskutuar statutin e 'Trepçës'. Futja e çështjeve sociale në statut nuk është zgjidhje e duhur, pasi Statuti i

Ndërmarrjes 'Trepça' mund të ndryshojë në çdo kohë dhe kjo rrjedhimisht nuk do t'i zgjidhte problemet sociale, por do të krijonte obligime financiare për ndërmarrjen të cilat do të ishin të papërbalueshme", ka thënë ai, duke shtuar se mënyra e vetme që çështjet sociale të zgjidhen njëherë e përgjithmonë për gjithë punonjësit e "Trepçës" është përmes ligjit të veçantë. "Bordi Mbikëqyrës i siguron të gjithë punëtorët e 'Trepçës' se të gjitha vendimet tona do të jenë të menduara mirë dhe në harmoni me ligjet në fuqi. Krahas zhvillimit të qëndrueshëm të ndërmarrjes 'Trepça' sh. a. do të trajtohen edhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punëtorët", është shprehur Syla.

Gërxhaliu: Dënimi i 'Elkos Group'-it, politik

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) përmes një konference për medie kanë reaguar të enjten ndaj dënimit prej 1.3 milion eurove që Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) i ka shqiptuar kompanisë "Elkos Group", pronar i së cilës është deputeti e LDK-së, Ramiz Kelmendi.

Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se është shqetësuese që një ndërmarrje e tillë të goditet për shkak të revansheve politike e personale. "Elkos Group"-i është një brend që vërtet e bën krenare ndërmarrësinë kosovare jo vetëm si tregtar, por edhe si prodhues, si eksportues dhe si një nga kontribuuesit më të mëdhenj në stabilitetin social në Kosovë. Një nga tatimpaguesit më të rregullt dhe kontribuues në buxhetin e Kosovës. Është një politizim i



skajshëm i qasjes së disa institucioneve dhe agjenci përballë bizneseve. Në këtë drejtim nuk i bëhet nder Kosovës dhe ardhmërisë së Kosovës në qoftë se vazhdohet me këtë penalizim të kundërshtarëve politikë. Shumica e asaj që ka ndodhur është paradoksale, por shqetësimi më i madh për Odën Ekonomike është në kohën kur në Kosovë ka rënë përgjegjësia individuale dhe institucionale sa i përket menaxhimit të parasë publike. Kur një kompani e tillë goditet në këtë mënyrë të drejtpërdrejtë për hir të revanshizmit

qoftë politik, qoftë partiak, është mjerimi më i madh që e dëmton Kosovën edhe në aspektin intern, edhe në aspektin ekstern", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka shtuar se kjo jo vetëm e dëmton imazhin e kompanisë, por edhe Kosovën në aspektin e tërheqjes së investimeve të huaja.

Kurse përfaqësuesi i kompanisë "Elkos Group", Fatos Islami, ka thënë se kompania e tyre ka kryer të gjithë detyrimet që janë paraparë në kontratë, e cila është nënshkruar në vitin 2011 dhe se për këtë kanë dëshmi.

Sllovenët të interesuar për investime në energji përmes riciklimit të mbeturinave

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka pritur të enjten në takim një delegacion të biznesmenëve sllovenë që kanë shprehur interesim për të investuar në Kosovë në fushën e riciklimit të mbeturinave.

Ministri Hasani këtë delegacion e ka informuar për kushtet që i ofron Kosova për investitorët e huaj dhe për Ligjin e Investimeve Strategjike që ka një mori lehtësirash. "Sa i përket ministrisë që drejtoj unë, është e thirrur për ofrimin e kushteve për investitorë dhe jemi bartës të Ligjit për Investime Strategjike. Ky ligj parasheh që çdo investim mbi 10 milionë euro mund ta

marrë statusin e investitorit strategjik. Marrja e këtij statusi është marrje e përgjegjësisë për ecjen e të gjitha procedurave dhe jemi të obliguar t'ia krijojmë të gjitha kushtet në afatin ligjor dhe, po ashtu, kemi obligim ligjor që t'ia sigurojmë vendin ku do të vendoset", ka thënë Hasani.

Ministri ka theksuar se Kosova ka marrë një sërë reformash fiskale që mundësojnë operimin edhe më të lehtë të bizneseve. Investitorët sllovenë shprehën interesim që të investojnë në Kosovë në lëmin e riciklimit të mbeturinave dhe materialeve të rrezikshme.

Teknologjia që parashihet të vijë në Kosovë është me e reja, që

është shpikur para dy vjetësh dhe që funksionon në Zvicër dhe është shumë speciale për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme.

Teknologjia që parashihet të vijë në Kosovë punon në temperatura shumë të larta, 1 200 gradë celsius dhe materialet që digjen i shndërron në gaz (plin) dhe prodhon energji elektrike.

Vlen të theksohet se makineria i ka të gjitha testet dhe është e licencuar në Bashkimin Evropian. Është shumë ekologjike dhe miqësore për ambientin. Investimi parashihet të jetë mbi 10 milionë euro, varësisht prej sigurimit të lëndës së parë.



Qytetarët e Skenderajt kërkojnë investime në infrastrukturë dhe bujqësi

SKENDERAJ, 28 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka mbajtur dëgjim publik për kornizën afatmesme buxhetore 2019/21 mbi bazën e qarkores buxhetore 2019/01 të Ministrisë së



Financave, si dhe projekcionet fillestare të projekteve kapitale që do të përfshihen në projektbuxhetin e kësaj komune. Në këtë dëgjim publik kanë marrë pjesë nënkryetari i Skenderajt, Nuredin Lushtaku, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti, drejtorë të drejtorive komunale, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, qytetarë, profesionistë dhe përfaqësues nga OSBE-ja.

Nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, ka folur për rëndësinë e kornizës afatmesme buxhetore. Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Mehmet Berisha, ka thënë se qëllimi i këtyre dëgjimeve është që qyte-

tarët t'i paraqesin nevojat dhe prioritetet e investimeve në secilin lokalitet, me qëllim që në planifikimet buxhetore të hyjnë projektet që janë me interes të tyre. Ai ka kërkuar nga qytetarët të kontribuojnë me propozime për investime në projekte konkrete, të cilat do të shqyrtohen nga ekzekutivi i Komunës së Skenderajt. Gjatë dëgjimit publik, qytetarët kanë bërë propozime dhe kërkesa konkrete për nevojat në investime, qoftë në infrastrukturë apo edhe në subvencionime, të cilat do të përfshihen në projekcionet fillestare të investimeve kapitale në kornizën afatmesme buxhetore 2019/21.



Prishtina promovon pemët ekologjike

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka promovuar të enjten produktin "TE Pema T", i realizuar nga studentët e Inxhinierisë së Ambientit dhe Mekatronikës dhe është mbështetur nga UNICEF Innovation Lab Kosova. Të gjitha pjesët përbërëse të këtij

produkti janë vendore. "TE Pema T" është i mbushur me bimë që kanë aftësi shumë të mëdha të filtrimit të ajrit dhe prodhimit të oksigjenit. Kjo është e mundur falë renditjes, pozitës dhe sistemit automatik të ujitjes i cili bën që bimët ta filtojnë ajrin me kapacitet maksi-

mal. Produkte të tilla janë të mirëseardhura në Prishtinë, kur dihet problemi i shpeshtë që kemi me ndotjen e ajrit. Efekti që ka "TE Pema T" për pastrimin e ajrit është i barabartë me efektin që mund të kenë 70 fidane të mbjella në Prishtinë.



Lladrovci ndërpret dy kontrata për mospërbushje të obligimeve ligjore

DRENAS, 28 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, që nga marrja e mandatit është zotuar se do ta mbrojë pronën komunale. Në këtë kontekst, ai të enjten ka marrë vendim për shkëputjen e kontratave për personin fizik, Naser M. Gashi dhe personin juridik NTP "Mali-Com" për shkak të mospërbushjes së kontratave të lidhura me Komunën e Drenasit. "Më datën 30. 3. 2018 kryetari Lladrovci ka marrë vendim për

formimin e komisionit mbi vlerësimin e zbatueshmërisë së procedurave ligjore për dhënie e pronave komunale në shfrytëzim dhe përbushjes së obligimeve kontraktuese, ndërsa më datën 8. 6. 2018 ky komision ka ofruar raportin për këto kontrata. Ndërprerja e kontratës me numër 353-46310 të datës 23. 10. 2014 dhe numri i kontratës 353-46330 i datës 23. 10. 2014 janë bërë në bazë të vlerësimit të këtij raporti të Komisionit me numër 01-464-32760 i

datës 8. 6. 2018", është thënë në njoftimin e Komunës së Drenasit. Sipas planit dinamik, të dy qiramarrësit e pronës komunale kanë qenë të obliguar që objektin ta përfundojnë brenda 18 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës, mirëpo qiramarrësit nuk i kanë përbushur obligimet e kontratës së nënshkruar. Sipas njoftimit të komunës, qiramarrësit nuk i kanë përbushur as obligimet për punësimin e nëntë punëtorëve.

KRU 'Prishtina', me performancën më të mirë për vitin 2017

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), me rastin e prezantimit të performancës së kompanive rajonale të ujësjellësve dhe kanalizimeve të Republikës së Kosovës, ka ndarë mirënjohje për Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh. a. për performancën më të mirë për vitin 2017. Sipas një njoftimi të KRU "Prishtina", ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare është synimi aktual dhe i së ardhmes i kësaj kompanie. "Misioni i KRU 'Prishtina' sh. a. është furnizimi me ujë të pijshëm në pajtim me standardet e OBSH-së, maksimalizimi i kohës së furnizimit, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ujit të pijshëm, mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ujërave të ndotura", është bërë me dije në njoftimin për medie. KRU "Prishtina" ka njoftuar se orientimi i të gjitha aktiviteteve të



punës do të kenë çdoherë fokus konsumatorin me të gjitha përfitimet dhe rreziqet. "Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim human dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore etj", është theksuar në njoftimin për medie të KRU "Prishtina".

Sokol Havolli emërohet zëvendësguvernator i BOK-së

Prishtinë, 28 qershor - Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BOK) ka emëruar Sokol

Havllin në pozitën e zëvendësguvernatorit të BOK-së. Po ashtu, ky bord ka miratuar Rregulloren

për Sistemin e Pagesave Ndërbankare dhe Pasqyrat Financiare për tremujorin e parë të vitit

2018. Sokol Havolli gjatë mandatit të kaluar qeverisës ka qenë këshilltar i Isa Mustafës.



Bashkimi Evropian dhe korrupsioni në Kosovë



Akademik Rexhep QOSJA

Korrupsioni!
Nepotizmi!
Korrupsioni dhe nepotizmi!
Këshilli kombëtar kundër korrupsionit!
Agjencia kundër korrupsionit!
Java e luftës kundër korrupsionit!
Lufta kundër korrupsionit!
Siç po shihet, në Kosovë sot kemi:
1-Këshilli kombëtar kundër korrupsionit.
2-Agjenci kundër korrupsionit.
3-Javë të luftës kundër korrupsionit.
4-Luftë kundër korrupsionit.

Por, nuk kemi as Këshill, as Agjenci, as Javë, as Luftë kundër nepotizmit, megjithëse nepotizmi është një përbërës i korrupsionit me pasoja të mëdha politike, administrative, shtetërore e morale në jetën shoqërore në Kosovë. Në Këshillin kombëtar kundër korrupsionit dhe në Agjencinë kundër korrupsionit marrin pjesë, sigurisht të emëruar prej institucioneve të larta shtetërore, anëtarë të partive, për të cilët, pothuajse nuk dihet se si, në ç'mënyrë, me çka e luftojnë korrupsionin!

Në Javën kundër korrupsionit, përpos përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, marrin pjesë kur e kur edhe ambasadorë të huaj në Kosovë. Kështu, fjala vjen, në Javën e fundit të kësaj luftë kundër korrupsionit, mori pjesë edhe Ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Greg Delawie. Me këtë rast ai e tha edhe një fjalë shumë të rëndësishme: lufta kundër korrupsionit është me rëndësi shumë të madhe për Kosovën.

Në Luftën kundër korrupsionit, që s'është vetëm e Këshillit, as vetëm e Agjencisë, as vetëm e Javës, as vetëm mujore a vjetore, por "e përhershme", thonë zyrtarët e Kosovës, por mosekzistuese, thonë qytetarët e Kosovës, marrin pjesë edhe disa përfaqësues të organizatave joqeveritare të Kosovës, edhe ndonjë intelektual, edhe ndonjë diplomat i huaj në Kosovë, por ndodh të marrë pjesë, ç'është e vërteta mjaft rrallë, edhe ndonjëri prej zyrtarëve të lartë të Kosovës. Kështu, fjala vjen, njëri prej tyre, që para disa ditësh mori pjesë në këtë luftë kundër korrupsionit, deklaroi se "lufta kundër korrupsionit

është agjendë e jona e përditshme", në të vërtetë agjendë e asnjëditshme e pushtetarëve, u përgjigj një gazetar zështrerr!

Por çka është edhe më e rëndësishme për Kosovën, në këtë Luftë të përhershme kundër korrupsionit në Kosovë, në të cilën përmbledhen edhe lufta e Këshillit, edhe lufta e Agjencisë, edhe lufta e Javës, edhe lufta mujore e edhe lufta vjetore kundër korrupsionit në Kosovë, marrin pjesë edhe përfaqësues të Bashkimit Evropian. Dhe, marrin pjesë në këtë luftë kundër korrupsionit në Kosovë me mendime më pak a më shumë të ndryshme. Kështu, fjala vjen, njëri prej tyre korrupsionin në Kosovë e ka quajtur korrupsion pandemik; një tjetër e ka quajtur kancer politik e shtetëror, kurse një i tretë, shumë kohë para këtyre të dyve, e ka quajtur tradhti ndaj popullit.

Dhe, me gjithë luftën e Këshillit kosovar për luftën kundër korrupsionit, dhe me gjithë luftën e Agjencisë kosovare kundër korrupsionit, dhe me gjithë luftën e Javës kosovare kundër korrupsionit, dhe me gjithë këtë luftë të "përditshme" të Luftës kundër korrupsionit, dhe me gjithë pjesëmarrjen në këtë Luftë heroike kundër korrupsionit të një vargu përfaqësuesish të organizatave joqeveritare, të një vargu njerëzish politikë, të disa zyrtarëve të parë politikë e shtetërorë, të disa diplomatëve të huaj në Kosovë dhe, më në fund, të disa autoriteteve të larta të Bashkimit Evropian, korrupsioni në Kosovë vazhdon të lulëzojë, vazhdon të jetë herë epidemik e herë pandemik, vazhdon të shtrihet gjerë, të depërtojë thellë e të ngrihet lart, deri në lartësitë më të mëdha politike e shtetërore të Kosovës!

Pse? Pse? Pse?

Pse kjo luftë kundër korrupsionit në Kosovë është kështu e pafryte, e pazejtë, e kotë? E mjerë?

E para, sepse është luftë e rrejshme, demagogjike, mashtruese ndaj popullit! E dyta, sepse është luftë me iluzione përfutuese retorike e patetike atdhetare e të pushtetshmëve dhe e të papushtetshmëve!

E treta, sepse është luftë në thelbin e saj e sabotuar prej të gjithëpushtetshmëve dhe e të gjithëfuqishmëve të Kosovës dhe është e sabotuar prej tyre sepse ata janë të frikësuar se po të bëhej kjo luftë kundër korrupsionit kur duhet, ku duhet, si duhet e me çka duhet ata do të mund të ishin shpallur të kryekorrup-tuarit e Kosovës.

E katërta, sepse është luftë në thelb e

politizuar, sa për sy e faqe, e autoriteteve të Bashkimit Evropian. Po të mos ishte e tillë, po të mos ishte e politizuar, po të mos ishte e disafytyrshme sjellja e tij, EULEX-i nuk do të pësonte disfatë pothuaj komprometuese në Kosovë! Po të mos ishte kështu, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell, betejën e tij disamujore kundër të keqes së madhe të quajtur nepotizëm nuk do ta heshtte përnjëherë dhe tani të shihet aq shpesh në shoqëri e në gosti me politikanët, përfutuesit dhe zbatuesit e shquar të nepotizmit në Kosovë!

Autoritetet e Bashkimit Evropian, po deshën ta luftojnë sinqerisht, po deshën ta luftojnë vendosmërisht korrupsionin (dhe nepotizmin) në Kosovë, nuk e kanë aspak të vështirë: do të duhej të bëjnë në këtë luftë çka bëjnë në vendet e tyre. Ata e dinë mirë se korrupsioni (e nepotizmi) nuk parandalohen, nuk pakësohen, nuk çrrënjosen duke burgosur për korrupsion pylltarë, infermierë, kamerierë, mësues në fshatra e qyteza, korrierë partiakë e shkollorë, analfabetë e çerek-intelektualë të profesioneve të ndryshme, po duke luftuar më së pari korrupsionin e të gjithëpushtetshmëve e të gjithëfuqishmëve, sot 30,40 apo 50 herë më të pasur se ditën kur janë ulur në postet politike, të cilët me pasuritë e tyre e të familjarëve të tyre, me sjelljet e tyre e me disa "ligje" të tyre, në të vërtetë e kanë legalizuar korrupsionin dhe të cilët tashmë kapardisen si sundimtarë të sulltanizuar, që Kosovën e trajtojnë shtet të tyre privat!

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, zonja Nataliya Apostolova, fjala e së cilës tingëllon e sinqertë, e bindshme dhe përshtypjebërëse, nuk ka nevojë të harxhojë shumë fjalë për korrupsionin këtu në Kosovë: Ajo do të duhej të përpiquej që në Bruksel të krijohet vetëdija e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian se për të pakësuar, për të parandaluar, për të çrrënjësuar një ditë korrupsionin në Kosovë duhet të bëhet ajo që është bërë në shtetin e saj - në Bullgari: e para, duhet të miratohet Ligji për prejardhjen e pasurive të zyrtarëve të lartë, të "peshqve të mëdhenj", në Kosovë, duke filluar prej kryetarit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit e të "peshqve të tjerë të mëdhenj e të mesëm" pas tyre; e dyta, duhet të caktohet prokuror i veçantë, pra i veçantë e jo rrogatari i kryetarit e kryeministrit, i cili do të merrej me hetimin, prejardhjen, grumbullimin e atyre pasurive; dhe, e treta, duhet të nxirret gjyqësori kosovar prej thonjve të kryepronarëve sulltanorë

të shtetit të Kosovës!

Ç'është e vërteta Kosova ka Këshill kombëtar për luftë kundër korrupsionit, Agjenci kombëtare kundër korrupsionit, Javë të luftës kundër korrupsionit, prokuror për luftë kundër korrupsionit e shumëçka tjetër që ka të bëjë me korrupsionin, por pushteti në Kosovë sot shumë më shumë se luftë kundër korrupsionit ka gënjeshtër, mashtrime, dallavere, falsifikime, trillime, sabotime vrazhdësi, kërcënime, dhunë, zhvatje, reket, privilegje, derdhje të financave shtetërore, shantazhime që e asgjësojnë atë luftë kundër korrupsionit. Për të gjitha këto arsye Kosova ka nevojë për një prokuror të veçantë, të pavarur, me integritet të veçantë politik, profesional, moral, që puthadorësit e puthakëmbësit e të gjithë të pushtetshmëve siç është prokurorja e lavdishme rumune, Laura Kovesi, e cila me vendosmërinë e saj të pamposhtshme ka arritur t'i nxjerrë para gjykatave të kryekorrup-tuarit e Rumanisë dhe t'i mbushë burgjet me ta e me të korruptuar të tjerë si ata. Në sajë të veprimtarisë së saj si prokurore me përgjegjshmëri e përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj drejtësisë, demokracisë dhe popullit të cilit i takon, që brenda një viti, si shkruajnë mediet evropiane, i realizon deri në njëmijë hetime të zyrtarëve shtetërorë prej të cilëve 90 për qind përfundojnë në burgje, ajo është bërë gjerësisht e njohur dhe e çmuar në Evropë e në botë. Është lartëçmuar prej Kryetarit të Komisionit Evropian, Zhan Klod Juncker, prej medieve të njohura si New York Times e Gardian dhe, më në fund, është çmuar edhe me dekoratën më të lartë të Francës: me Dekoratën e Nderit.

Vetëm ashtu, me ligj, dhe vetëm me ligj, me shtet të së drejtës dhe vetëm me shtet të së drejtës, mund të shërohet Kosova prej sëmundjes së rëndë të quajtur korrupsion (e nepotizëm), që cenon, shfityron demokracinë tonë ende rurale, që pengon zhvillimin ekonomik, që vret shtetin social, që nxit dëshpërimin e qytetarëve ndaj shtetit dhe vendit të vet, që nxit mosdurimin e arsyeshëm të qytetarëve ndaj strukturave politike, partiake e shtetërore, që nxit zhvendosjen sidomos të të rinjve prej Kosovës, që bëhet rëndësë, domethënë fuqi tërheqëse e krimi të organizuar, që e përshtin dhe e përthellon krizën morale të shoqërisë e shtetit të Kosovës! Të gjitha këto pasoja të korrupsionit janë të mjafta që ai, korrupsioni, të quhet siç e ka quajtur ai evropiani i shumëpërvojshëm: tradhti ndaj popullit.

Shira të rrëmbyeshëm në Greqi

ATHINË, 28 QERSHOR - Reshje të shumta shiu kanë mbuluar të enjten kryeqytetin e Greqisë. Reshjet që janë ndër më të lar-

tat të shënuara ndonjëherë, deri tani kanë krijuar probleme të mëdha në zonën lindore të kryeqytetit. Janë rapor-

tuar disa dhjetëra godina të përmbytura. Ujërat e shumta bllokuan aksin që lidh Athinën me Korinthin në Zonën e

Elfesisë, pikërisht në vendin ku më pak se një vit më parë u shënuan më shumë se 20 të vdekur nga përmbytjet.



Udhëheqësit e BE-së shqyrtojnë reforma të reja të emigracionit

BRUKSEL, 28 QERSHOR - Gjatë samitit të tyre dyditor, udhëheqësit e Bashkimit Evropian (BE) po shqyrtojnë reformën e emigracionit. Disa vende mbështesnin politikën e dyerve të hapura, ndërsa vende të tjera ngritën barrkada që do ta pengonin lëvizjen e mëtejshme të emigrantëve të gjendur tashmë brenda Evropës. Në vitin 2015, BE-ja pati njoftuar se pati mbi 1.8 milion emigrantë të paligjshëm që hynë në territorin e saj.

Përpara samitit, presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka shkruar në një letër, se numri i kalimeve të paligjshme të kufirit ka rënë me 96 për qind që nga kulmi i krizës. Politikën e zbatuar deri më tani kanë ndihmuar për ta ulur këtë numër, ndër to një marrëveshje e arritur me Turqinë

për t'i ndërprerë shtigjet e emigracionit, si dhe për të ripranuar ata që ia dalin të kalojnë drejt Greqisë.

Bashkimi Evropian filloi gjithashtu punën për të trajtuar në origjinë problemet që i shtojnë njerëzit t'i braktisin shtëpitë e tyre.

Tusk ka propozuar reforma të mëtejshme, ndër to edhe krijimin e "platformave rajonale të zbarkimit", ku me ndihmën e agjencisë së OKB-së për refugjatët dhe Organizatës Ndërkombëtare për Emigracionin, BE-ja mund të shqyrtojë jashtë territorit të saj rastet e azilkërkuësve, duke mos lejuar kështu aktivitetin e trafikantëve dhe kalimin e rrezikshëm përmes deteve.

Tusk po u kërkon gjithashtu vendeve anëtare të BE-së që të



bashkëpunojnë me vendet e origjinës, në veçanti me Libinë. "Gjithnjë e më shumë njerëz po fillojnë të besojnë se vetëm autoriteti i dorës së fortë, me frymë anti-evropiane dhe anti-liberale, me një tendencë drejt autoritarizmit, do të jetë në

gjendje të ndalojë një valë emigracioni", ka shkruar Tusk, për të shtuar: "Nëse njerëzit e besojnë se vetëm kështu mund të ofrohet një zgjidhje efektive ndaj krizës së emigracionit, ata gjithashtu do të besojnë edhe gjithçka tjetër që mund t'ju thuhet. Momenti është

tepër i rëndësishëm dhe koha është e pakët".

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, e cila në kulmin e krizës u radhit mes mbështetësve të politikës për të mirëpritur emigrantët, ndodhet tashmë nën presion nga kritikët në vendin e saj, të cilët thonë se Gjermania ka qenë më tepër mikpritëse se ç'duhet.

Përpara se të nisej drejt Brukselit, ajo i tha parlamentit ditën e enjte se pati marrë vendimin e duhur në një situatë të jashtëzakonshme, por se në situatën e tanishme, BE-ja duhet të vendosë një kontroll më të fortë. Merkel ka theksuar se megjithëse ka përçarje mes vendeve anëtare, ato janë të bashkuara për nevojën e zvogëlimit të emigracionit të përgjithshëm, për ndalimin e trafikantëve, si dhe forcimin e kufijve të jashtëm të BE-së.



OKB-ja: Mbi 10 mijë fëmijë të vrarë në konflikte

NYU JORK, 28 QERSHOR - Mbi 10 000 fëmijë janë vrarë ose plagosur në konfliktet e armatosura vitin e kaluar, ndërsa të tjerë janë përdhunuar, detyruar të shërbejnë si ushtarë ose janë marrë peng nga shkollat dhe spitalet, thuhet në një raport të Kombeve të Bashkuara. Raporti vjetor "Fëmijët dhe Konflikti i Armatosur" po ashtu nxjerr në pah se, në vitin 2017, janë raportuar mbi 21,000 shkelje të të drejtave të fëmi-

jëve, çfarë nënkupton një rritje të mprehtë nga viti paraprak, kur janë raportuar rreth 15,500 raste të tilla. Në Siri, fëmijët kanë pësuar numrin më të madh të shkeljeve të të drejtave të tyre, theksohet në raport. Sipas tij, krizat në Republikën e Afrikës Qendrore, në Republikën Demokratike të Kongos, në Mianmar, në Sudanin e Jugut dhe në Jemen kanë kontribuar po ashtu në rritjen e dhunës ndaj fëmijëve.

Trumpi dhe Putini do të takohen në Finlandë më 16 korrik

UASHINGTON, 28 QERSHOR - Presidenti amerikan, Donald Trump, dhe presidenti rus Vladimir Putin, do të takohen në Helsinkë të Finlandës më 16 korrik, ka njoftuar Shtëpia e Bardhë dhe Kremlin. Planet u finalizuan nga këshilltari i sigurisë kombëtare të ShBA-ve, John Bolton, i cili mbajti takime të shumta në Moskë, duke përfshirë edhe një me presidentin Putin. Takimi i pritshëm mes dy presidentëve sinjalizon një afrim në rritje mes ShBA-së

dhe Rusisë. Presidenti Trump ka thënë se të kesh marrëdhënie të mira me Rusinë dhe me Kinën si dhe me të gjithë është një gjë shumë e mirë. Ai ka pohuar se me presidentin Putin do të diskutonin mbi Sirinë, Ukrainën dhe "shumë tema të tjera". Pikërisht përpara se të njoftoheshin hollësitë e takimit të korrikut, Trump ka komentuar në rrjetin social në "Twitter": "Rusia vazhdon të thotë se ata nuk kanë të bëjnë me ndërhyrjen në

zgjedhjet tona".

Presidenti Trump e ka përsëritur vazhdimisht deklaratën e Rusisë se ajo nuk ka ndërhyrë në zgjedhjet amerikane të vitit 2016. Kjo e ka vënë atë në mospërputhje me gjetjet e komunitetit amerikan të zbulimit si dhe me gati të gjithë demokratët dhe republikanët në Kongres të cilët thonë se ka prova të qarta lidhur me përpjekjet e Rusisë për të ndikuar në fushatën presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara.



Turqia do ta heqë gjendjen e jashtëzakonshme

Ankara, 28 qershor - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, dhe partneri i tij qeverisës kanë dakord të mos e vazhdojnë

gjendjen e jashtëzakonshme, kur periudha e saj aktuale tremujore të skadojë në korrik. Turqia është në gjendje të jashtëzakonshme

që nga një grushtshtet i dështuar në vitin 2016. Erdogan ka premtuar se do ta shfuqizojë atë nëse i fiton zgjedhjet presidenciale të 24

qershorit. Erdogan ka fituar me 53 % të votave duke e zgjatur mandatin e tij së paku deri në vitin 2023.





RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

Prishtinë

Pushimet, si të parandaloni stresin para nisjes

Duket një paradoks, por edhe periudhat që largohemi nga puna fshehin disa faktorë që mund të rrezikojnë mirëqenien tonë

Duket një kontradiktë termash, por gjërat janë me të vërtetë të tilla: stresi i pushimeve ekziston dhe mund të rrezikojë performancën e mirë të periudhës sonë të pushimeve. Kur jeni larg nga shtëpia, ju e dini, gjërat nuk shkojnë gjithmonë siç i presim: struktura e zgjedhur nuk mund të korrespondojë me pritjet tona, mund të ketë aksidente në lëvizje, ushqimi lokal ndonjëherë nuk është i pëlqyer. Për më tepër, udhëtimi gjithmonë përfshin njëfarë aventurie dhe kërkon një minimum fleksibiliteti dhe përshtatshmërie: ekzistojnë disa burime stresi tipike të kohës së sotme, të lidhura me simbolet e statusit dhe qëndrimet e gabuara, të cilat mund dhe (duhet) t'i mësojmë t'i menaxhojmë sepse varen ... nga koka jonë.

Ankthi i nisjes - Përgatitja e bagazheve dhe mbyllja e shtëpisë para se të nisemi me pushime janë çmimi i pashmangshëm që paguajmë në ditët para fillimit: këto aktivitete shkaktojnë stres dhe ankth në shumë njerëz. Gjithashtu organizimi i udhëtimit, rezervimet dhe kostot e pashmangshme, mund të krijojnë ngutje dhe humor të keq, si për shembull rritjen e punës në zyrë

për të kompensuar periudhën e mungesës. Zgjidhja është të lëvizësh në kohë, në mënyrë që të përhapësh angazhimet gjatë disa ditëve dhe të shmangësh ngutjen e madhe në minutën e fundit. Nëse ndodh që të marrim disa ditë më shumë se kolegët tanë ose të largohemi jashtë sezonit, kur të tjerët po punojnë ende, mund të ndodhë që kolegët në zyrë të na shikojnë shtrembër. Duke qenë se situata është kështu vlen të mos vërehet. Ndjenja e fajit, duke përfshirë edhe atë që të tjerët na bëjnë të ndihemi, është e gabuar: në qoftë se ne kemi më shumë pushime, kjo do të thotë se ne nuk kemi gëzuar në të kaluarën, ose që nisemi para të tjerëve, do të thotë se nga ajo do të parashikohet edhe kthimi. Sidoqoftë, është e padobishme të ndihemi në faj: bëjmë detyrën tonë dhe nisemi të qetë.

Mos i idealizoni pushimet - Periudha e pushimeve është një fazë jete, dhe jo momenti kur duhet të jemi absolutisht perfekt. Mos prisni shumë nga pushimet dhe mbi të gjitha mos e imagjinoni atë si kohën për të rimarrë gjithçka që nuk mund të bëjmë gjatë muajve të vitit. Për shembull: është e kotë të largohemi në një udhëtim super sfidues nëse për



njëmbëdhjetë muajt e mëparshëm nuk jeni ngritur kurrë nga tavolina dhe nuk keni bërë asnjë trajnim, ose të marrim me vete një bibliotekë të tërë të klasikëve të letërsisë sepse gjatë vitit nuk kemi pasur kohë për të lexuar. Një gabim tjetër për të shmangur: t'i konsiderosh pushimet si një lloj kompensimi për punët gjatë një viti. Le të kufizohemi të marrim nga ato pushime një moment pauze dhe relaksi, duke i shfrytëzuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe në shoqëri të mirë.

Le të mos bëhemi superheronj - Është e padobishme të planifikosh çdo moment të vetëm të pushimeve midis udhëtimeve, sporteve, vizitave kulturore ose argëtimeve të pafundme të natës. Le t'i japim vetes kohë të mësohemi me klimën dhe situatën e re, të

pushojmë me të vërtetë dhe ndoshta edhe të shqetësohemi pak. Sporti është mirë, por në përpjesëtim me mundësitë tona dhe kushtet tona fizike.

Objektivi: jo të lidhur - Technostress është një tjetër armik i pushimit të Mijëvjeçarit të Tretë. Nëse jemi me pushime, por ne vazhdojmë të qëndrojmë të lidhur, të kontrollojmë vazhdimisht e-mailat dhe të përgjigjemi në telefon sikur të ishim në zyrë, pushimi ynë pa dyshim do të jetë një pushim i vogël. Zgjidhjet? Ka vetëm një: shpërnguni nga pajisjet e ndryshme dhe më në fund e lironi mendjen. Nëse me të vërtetë nuk mund të bëjmë pa qenë të disponueshëm, të paktën përipiqemi të kufizojmë aktivitetin tonë në një vend të caktuar kohor, ndoshta duke mbledhur mesazhe

me një sekretari telefonike dhe një përgjigjësi.

Pushimet e fqinjët janë gjithnjë...

- Siç thotë proverba, pushimet e miqve dhe të njohurve, na duken gjithnjë e më interesante, më rrëzëllitëse, më emocionuese sesa tonat. Tani që nuk mund të rrimë pa postuar selfie dhe fotografi që dokumentojnë lëvizjet tona me të gjitha detajet, është e papashmangshme që të mos i bëjmë miqtë dhe të njohurit të bëjnë krahasime. Dhe duke qenë se të gjithë tentojnë të tregojnë gjërat më të bukura, ne gjejmë veten duke zbuluar një koleksion të kartolinave idilike të bëra nga deti i pacenuar, qielli blu dhe buzëqeshjet e fëmijëve. Kjo mund të na bëjë të ndjehemi të zhgënjyer dhe edhe më të pakënaqur nëse gjejmë veten në një plazh të mbushur me njerëz ose në një hotel jo me pesë yje. Edhe këtu zgjidhja është shpërnguni. Forcat e Policisë, ndër të tjera, këshillojnë që të mos postoni kronika në kohë reale dhe fotot e pushimeve në rrjetet sociale: duke u shfaqur të qeshur në Tropikë është ekuivalente me raportimin e minjve të banesës dhe njerëzve të këqinj që na kanë hyrë në shtëpinë e pabanuar. Është më mirë të publikoni retrospektivisht revistat e udhëtimit, në kthimin tonë dhe pushimet e përfunduara.

(gazeta-Shqip.com)

Koha e nxirjes, disa këshilla për të shmangur djegiet nga dielli

Vera është koha e duhur për nxirje, por ekspozimi në diell, është gjithashtu vendimtar për rritjen e eshtrave, sidomos te fëmijët, pasi stimulon prodhimin e vitaminës D. Rreziqet, sidoqoftë, po mbesin, në mungesë të mbrojtjes adekuate, duke filluar nga djegiet më të rrezikshme. Është një ftesë për të "mos demonizuar" diellin ajo që vjen nga Maurizio Nudo, kreu i kirurgjisë dermatologjike dhe terapisë lazer të Institutit të Dermatologjisë IRCCS (IDI), por gjithashtu të mos harrojmë masat themelore për të shmangur pasojat e pakëndshme.

"Të marrësh rreze, - shpjegon eksperti, - sigurisht na bën mirë, duke filluar nga fëmijët tek të moshuarit, dhe kjo sepse ekspozimi ndaj diellit liron vitaminën D të qenësishme në trupin tonë; një vitaminë themelore sepse stimulon rritjen e eshtrave". Megjithatë, nuk duhet të harrojmë rreziqet që lidhen me ekspozimin e tepruar: "Rreziku më i madh, - thotë Nudo, - përfaqësohet nga djegiet diellore që mund të rezultojnë në lindjen e



moleve që, nga ana tjetër, mund të zhvillojnë kancer të lëkurës, si melanoma ose forma të tjera me një shkallë të ulët të malignancy, por në çdo rast serioze si epiteliozom qelizore basale dhe epitelieve spinocellulare, që shpesh gjenden në fytyrë". Për më tepër, paralajmëron, djegiet diellore "mund të kenë efektin e transformimit të atyre ekzistues në melanomë, një rrezik që gjithashtu prek fëmijët". Prandaj ja për masat e duhura që duhen marrë. Masat paraprake janë të njohura, thotë specialisti, "por fatqësisht

ende, shumë shpesh, nuk zbatohen nga shumë dashamirës të diellit dhe rrezitjes". Rregulli i parë, ju duhet të mbron veten gjithmonë me filtra dhe krem solar: "Janë filtra dhe kremra të bëra nga kimikatet, por për personat alergjikë, - kujton Nudo, - tani janë gjithashtu në dispozicion edhe filtra të veçantë të ashtuquajtur 'fizikë', bazuar në dioksid titani, një substancë analergjike dhe për këtë arsye e përshtatshme për subjektet me probleme të këtij lloji". Një tjetër këshillë është ajo që lidhet me orët më të mira për t'u

ekspozuar: nga ora 8 deri në 11 dhe nga 16 në mbrëmje: "mes 12 dhe 15, në fakt, - thekson Nudo, - rrezet e diellit vijnë pingul dhe shkaktojnë shumë dëme në lëkurë".

Për individët më të ndjeshëm, të ashtuquajturit "lloji i lëkurës 1", është mirë të veshin bluza të bardha pambuku dhe kapele, pasi rreziku i djegieve mbetet i lartë me gjithë mbrojtjen me filtra ose kremra.

Për një nxirje të bukur, gjithashtu i rëndësishëm është ushqimi: "Hani shumë fruta dhe perime, veçanërisht pjepër, pjeshkë, ananas dhe kivi, sepse ato për-

bajnë pigmente që favorizojnë nxirjen. Frutat dhe perimet, - thekson, - janë gjithashtu të pasura në vitaminë PP, e rëndësishme për shkak se ka një funksion parandalues kundër plakjes dhe kancerit të lëkurës". Thelbësore gjithashtu është të pini shumë ujë, sepse "hidratimi i duhur parandalon plakjen e lëkurës". E fundit, por shumë e rëndësishme, këshillë: "Edhe fëmijët duhet të kontrollojnë molet, që kur janë shumë të vegjël. Edhe pse rrallë, në fakt, - përfundon eksperti, - tumoret e lëkurës diagnostikohen gjithashtu edhe tek të vegjlit".

(gazeta-Shqip.com)



Ndërron jetë babai i Michael Jacksonit



Joe Jackson, babai i legjendës së muzikës Michael Jacksonit, ka ndërruar jetë në moshën 89-vjeçare. Sipas "BBC", Jackson u shua mëngjesin e së mërkurës. Ai kishte disa ditë që ishte shtruar në spital, pasi vuante nga kanceri në pankreas.

Nipi Taj Jackson ka shkruar në llogarinë e vet në "Twitter". "Ma shpifin disa komente që po lexoj për gjyshin tim nga disa persona që nuk e njihnin. Ju lutem, mos pështyni aty ku jeni ushqyer. Joe ishte i dashur për familjet tona. Na lini të pikëllohem të qetë", ka shkruar Taj Jackson.



Moderatoja që u tradhtua një ditë para se të bëhej nënë do të martohet

Çdo dalje publike që ata bëjnë merr vëmendje të madhe. Duket se basketbollisti Tristan Thompson po bën çdo gjë për ta rregulluar marrëdhënien me moderatoren Khloe Kardashian. Video ku ai e tradhtonte me një striptiste u bë

virale dhe ndodhi një ditë para se të vinte në jetë vogëlushja e tyre. Por, duket se çdo gjë është zgjidhur dhe Khloe e ka falur. Të gjithë po spekulojnë se çifti është drejt finalizimit të lidhjes me martesë, por ende nuk është konfirmuar një gjë e tillë.

Djali i Johnny Deppit është në gjendje të rëndë shëndetësore

Djali adoleshent i Johnny Depp, Jack, po përballat me probleme të rënda shëndetësore. Nëna e tij Vanessa Paradis humbi premierën e filmit të saj të fundit në Paris për të qëndruar pranë 16-vjeçarit. Aktorja 45-vjeçare ka qenë dashur të merrte pjesë në premierën e filmit "A Knife In The Heart", por u detyrua ta anuloi minutën e fundit. Nuk dihet saktësisht se çfarë problemesh shëndetësore ka Jack.




Kanye ia shet komshiut apartamentin



Apartmenti i Kanye Westit në Nju Jork do të bëhet me pronar të ri, pasi reperi shiti pronën e tij në So Ho. Apartmenti i Kanye aktualisht përbëhet nga dy apartamente të cilat Kanye i kishte blerë në vitin 2004 dhe 2006, për 1.89 milion dhe 1.25 milion dollarë

respektivisht. Këngëtari më pas i kishte bashkuar, duke krijuar një apartament më të madh. Sipas "TMS" blerësi i këtij apartamenti veçse ka një të tillë në këtë vend. Duket se Kanye ka negociuar një marrëveshje të mirë me komshiun e tij.

					Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARI I FAMSHËM NË FOTO (shqip.)	E ÇELA	MJET I VOGËL ZYRE (shq.)	FILM I YNI "... ISHIN KATËR"	LIGJI, KANUNI (vjet.)	GAZETARJA SHQIPTARE ... TIÇO	EPOKA ERE	ZANORE	MJET XHIRIMI	FUTBOLLISTI FRANCEZ ... NASRI VDEKJE
					LLOJ ËMBËLSIRE						I ZOTËROJ ZANORE				
					I TRULLOSA (bised.)							ABBOTT MEDICAL OPTICS ELEKTRODA E POLIT POZITIV			
					DJALË OSE VAJZË DERI TETË A NËNTË VJEÇ						EMËR MASHKULLI MYSLIMAN TERRITORI I IMAMIT				
								ZANORE QULL I TRASHË ME MIELL MISRI (shq.)		I PLOGËT ALYSSA MILANO					
					AKTORJA AUSTRALIANE ... BLACK SPIUNIA E FAMSHME ... HARI					HYJNI E DASHURISË (mit romake) PËRGJIGJE NË TELEFON			SHPEND UJI SHTEGTAR (shq.)	SHTET NË AZI	
					ANDORA		"A" para dy "R"	SHKRIMTARI HAZIRI (shq.) MBRETURINAT E NJË KAFSHE PARAHISTORIKE							
					BATARE					MIMOZA AHMETI NJË LLOJ SHPATE JO SHUMË E MADHE			MOR, HEJ (psth.) SHALQI		
EPOKA ERE	HON	KËNGËTARJA AUSTRALIANE IMBRUGLIA (shqip.)	RRËMUJË	SHTET NË AMERIKË	EPOKA ERE	QYTET NË SHQIPËRI MODELJA ANGLEZE KATE ... (shqip.)							ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. orgj.) DHEMBJE E VESHIT		
					ISH SEKRETARI I OKB-së KOFI ...					BËRTHAMOR					
					ZË I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT			ISMET SHALA EMMY ROSSUM		TRAJNERI SPANJOLL VILANOVA PËRSHËNDETJE ALLATURKA			ZANORE I THAJ		
					BASHKËVENDËS I ODISEUT			KËNGËTARJA ... REÇI E LECKOSUR				OKSIGJEN, NIKEL ZANORE		PRAROJ	
					LLOJ SHALE PREJ DRURI ME DY KAPTEJ		JO E VJETËR BASHKËT.			E GRUSHTOVA E DREMITUR					
EPOKA ERE	GABZHERR, GURMAZ RRJET I NGATËRRUAR KALIMESH (shq.)							GAZETË QË BOTOHET NË SHQIPËRI KRUJA				PORTIERI KASILLAS FILLESTARE			
					AKTORI ÇELAJ		RIFAT KUKAJ BASHKËT.		AKTORI TURK IMIRZALIOGLU KËSHILLI NACIONAL				"ROTTERDAM" DAMARI I GJAKUT		
					ZANORE		POLITIKANI FERID ... SKIATORI		TRUP GJEOMETRIK RRIP PËR TË MBAJTUR PANTALLONAT		JARAN RRAFSHIM, BARAZIM LARTËSISH			BASHKËT. TENISTJA CLIJSTERS	
					BRITNEY SPEARS		UGANDA, TAJVANI "ROMA"		KËNGËTARI I FAMSHËM KARLOS LLOJ SHPENDI (sh.shq.)				ALFRED KAÇINARI ORGANISATION KONTAKTE INTERNATION.	AKTORJA AMERIKANE THIESSEN	
					VEZË PESHKU (shq.)		BUNAR I UJIT KOHË		ZANORE		I TRASH A I PRISH TEHUN SMALTI				
					FUTBOLLISTI ANGLEZ FERDINAND (MAN. UTD.)		KËNGËTARI ... ANTONI ISH FUTBOLLISTI NWANKWO (ARSENAL)		SHFUQIZIMI I NJË AKTI JURIDIK AKTORJA ... HUDSON (origj.)						
					ISMET TOTO		PA DOBI VLAAMSE ECONOMISCE KRING		ILAZ KODRA DIREK I ÇATISË		AKTORJA E FAMSHME ... STRIP ARBNOR (perkdh.)			BASHKËT. MINDER	
					ANIJATË (sh.shq.)			JETËSHKRIM IVAN DOIG					AKTORJA ANGLEZE ... FRIEL BASHKËT.		
					MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI		LLOJ LËNDE PLASËSE (shq.) BASHKËT.						EMËR YNI DJALI ISLANDA		
					I ARRATISUR		ANËTARËSIMI NË NJË PARTI						PËREMËR PRONOR		

E jashtëzakonshme

Komuna paguan të gjithë ata që shkojnë në punë me biçikletë

Duke filluar nga data 2 korrik, komuna e Cesenaticos do t'i paguajë të gjithë banorët që do të shkojnë në punë me biçikletë. Kjo është një nxitje që njerëzit t'i lënë makinat e tyre në



shtëpi dhe të shkojnë në punë me biçikleta. Projekti "Në punë me biçikletë" do të aplikohet në Cesena dhe Cesenatico.

FOTO E DITES



Një majmun shihet duke shikuar në kamerë në kopshtin zoologjik të Londrës. /Public domain/

E rrallë

Indiani adhuron Donald Trumpin si Perëndi

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka fansa në Amerikë, por adhuruesi i tij më i madh është një burrë që jeton në një kontinent tjetër. Bussa Krishna ka kaluar tri vjetët e fundit duke adhuruar Trumpin si një Perëndi. Ai mban një



fotografi të presidentit amerikan dhe i lutet atij disa herë në ditë.

BARSOLETA E DITËS



Vjen burri nga puna:

- Zemër, çfarë ka për të ngrënë?
- Asgjë.
- Po edhe dje pati "asgjë".
- Po, se kam gatuar për dy ditë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper, Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

**DASHI**


Rutina ju ka pushtuar ditën e sotme dhe

nuk do të keni asnjë arsye që mund t'ju bëjë disi më entuziast. Çdo gjë do të rrotullohet rreth një çështje biznesi.

**DEMI**

Jeni shumë krenar dhe ambicioz

dhe nuk pranoi se edhe ju mund të gaboni. Kjo lloj sjelljeje do t'ju bëjë shumë dëm në komunikim.

**BINJAKËT**

Sot dita do të kalojë qetë dhe

nuk do të keni ato debate që ju kanë shoqëruar kohët e fundit me partnerin.

**GAFORRJA**

Edhe pse sot në punë do të gjeni një

ambient agresiv ju nuk do të ndikoheni. Jeni shumë të qartë në objektivat tuaja.

**LUANI**

Në punë ose me studime, sot keni

vendosur që dita do të jetë me shumë aktivitete. Çdo gjë varet nga një përgjigje që do të jepni në fund të ditës.

**VIJGJËRËSHA**

Seksi dhe dashuria më në

fund po bashkohen për ju. Sot dita do të jetë shumë pasionante.

**PESHORJA**

Do të keni fat në lojë sot, por jo në dashuri.

Një zënkë me partnerin do t'ju mërzi dhe do të mbylleni në vetvete.

**AKREPI**

Sot do t'u tregoni eprrorëve tuaj se sa të

zotë jeni. Keni qaq kohë që dëshironi ta evidentoni punën tuaj dhe sot do të jetë dita.

**SHIGJETARI**

Dita do të kalojë në shoqëri të mirë dhe ju

do të besoni tek një mik i juaji një sekret të rëndësishëm.

**BRICJAPI**

Edhe pse keni pasur paragjykime

karshi një personi, sot do të zhiduken të gjitha. Bashkëpunimi juaj në të ardhmen do të jetë mjaft i ngushtë.

**UJORI**

Po merreni qetësisht me

interesat tuaja sot dhe çdo gjë tjetër ka kaluar në plan të dytë. Pasditja paraqitet e qetë.

**PESHQIT**

Sot do të jetë ditë e lumtur për ju, sepse

nuk do të zhgënjeheni nga ato momente që do t'ju ofrojë kjo ditë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

GOMEL - DINAMO BREST

GG

TPS - IFK MARIEHAMN

2

LAHTI - HJK HELSINKI

3+

Khudo ia sjell medaljen e tretë të artë Kosovës

Pas Nora Gjakovës dhe Distria Krasniqit, medaljen e artë në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018" e ka fituar edhe Akil Gjakova. Të enjten një sukses të madh e arriti edhe Erza Muminoviq, e cila është shpallur kampione e Evropës për kadete. Xhudoja rikonfirmohet edhe një herë tjetër si sporti numër një në Kosovë



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 QERSHOR - Sporti i xhudos vazhdon të jetë shtylla kryesore e shtetit të Kosovës, pasi të enjten e siguroi edhe medaljen e tretë të artë në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Kjo nuk ishte e tëra nga ky sport, pasi një sukses tjetër e arriti edhe xhudistja e re Erza Muminoviq, e cila është shpallur kampione e Evropës për kadete. Kjo e fundit në finale e mposhti në kategorinë 44 kilogramë kroaten Ana Viktorija Puljiz, për ta marrë medaljen e artë në këtë evropian.

Një porosi të fortë sporteve të tjera të Kosovës u ka dhënë kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, i cili ka porositur që

shtetin e Kosovës duhet të prezantohet edhe me rezultate dhe jo vetëm me emër. "Është kënaqësi që garuesit nga Federata e Xhudos të jenë të parët që dekorohen me medalje të arta në Lojërat Mesdhetare. Është kënaqësi që Kosova merr për herë të parë pjesë në këto lojëra dhe kënaqësia më e madhe është se këto po mbahen në Spanjë, shtet i cili ende nuk e ka pranuar pavarësinë e Kosovës. Shteti nuk prezantohet vetëm me emër, por me rezultate", ka thënë Kuka.

Një ditë pasi fituan medaljet e arta, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi të njëjtën gjë e bëri edhe Akil Gjakova. Ai raundin e parë e kaloi pa luftë, kurse në gjysmëfinale e mposhti me Ippon spanjollin Javier Ramirez në kategorinë - 73 kilogramë. Ndërsa në finale -73 kg, Akili e mposhti me Ippon, në

poenë të artë, Bilal Ciloglun. Ndryshe nga Akili, Laura Fazliu ishte e pafat në luftën për medaljen e bronzit në Lojërat Mesdhetare. Ajo pësoi humbje nga Busra Kapitoglu (Turqi) me Ippon në poenë të artë. Laura fitoi dy luftëra në repesazh dhe debutimi i saj me seniore vlerësohet i suksesshëm. I pranishëm në këto lojëra ishte edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi dhe kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani. Trajneri Driton Kuka i ka vlerësuar si me fat praninë e këtyre zyrtarëve të lartë të sportit. "Akil Gjakova i artë në Lojëra Mesdhetare. Prania e ministrit dhe kryetarit të KOK-ut ishte me fat. Tri të arta deri tash në Tarragona. Edhe Erza Muminoviq u bë e artë në Evropianin U18. Çfarë dite e madhe", ka shkruar Kuka në "Facebook".

SHKURT

Karabegu largohet nga Gjilani

Fuad Karabegu është futbollisti i radhës që largohet nga skuadra e Gjilanit në këtë afat kalimtar. Futbollisti në fjalë ka bërë me dije se nuk do të jetë pjesë e kësaj skuadre në edicionin e ri futbollistik, por ka falënderuar kryesinë, trajnerët, lojtarët dhe të gjithë ata që ishin pranë klubit. "Tash e tutje nuk do të jemi në projekte të përbashkëta. Gjilanit i uroj suksese në elitën e futbollit të Kosovës", ka thënë Karabegu.

Xhaka: Ëndrra vazhdon...

Edhe pse u ndal në një barazim 2-2 në ndeshjen e tretë në grup ndaj Kosta Rikës, Zvicra arriti të kualifikohet për në fazën e ardhshme në Botërorin e Rusisë. Por me anë të një statusi në llogarinë e tij të "Instagramit", Granit Xhaka, një prej lojtarëve më të formë te kombëtarja e Zvicrës, ka dashur të tregojë se ata nuk do të ndalen në këtë fazë, por do të vazhdojnë edhe më tej. "16 të fundit! Raundi i ardhshëm, ne po vijmë! Jemi gati për të punuar ende për ta vazhduar ëndrrën", ka shkruar Xhaka, ndër të tjera, në llogarinë personale në "Instagram". Xhaka dhe Shaqiri u bënë dy nga futbollistët më të komentuar në Botëror pas golave dhe festës me simbolin e shqiponjës në ndeshjen ndaj Serbisë.

Rooney transferohet te DC United

Ish-reprezentuesi i Anglisë dhe ish-lojtari i Manchester Unitedit, Wayne Rooney, do t'i bashkohet klubit amerikan DC United. Lajmin e ka konfirmuar skuadra e Evertonit, kurse Rooney ka nënshkruar kontratë tri-jeçare dhe i bashkohet kësaj skuadre më 10 korrik. Rooney ka shënuar 208 gola në Premierë Ligë për Evertonin dhe Manchester Unitedin.

Gabi largohet nga Atletico, shkon në Katar

Kapiteni i Atletico Madridit, Gabriel Fernandez Arenas, i njohur shkurt si Gabi, është larguar nga skuadra spanjolle. Ai do ta vazhdojë aventurën e tij në Katar, aty ku luan edhe Xavi, ish-kapiteni i Barcelonës. Gabi do të firmosë me Al Sadd për 3 sezone dhe nga kjo lëvizje do të përfitojë 19 milionë euro. Gabi ka luajtur 417 ndeshje zyrtare me Atletico Madridin, duke shënuar 10 gola e duke fituar gjashtë tituj.

Drita për fitore edhe ndaj Lincoln Reds Impsit

PRISHTINË, 28 QERSHOR (ER) - Skuadra e Dritës, pas fitores së parë historike në garat ndërkombëtare në gjysmëfinale ndaj skuadrës nga Andorra, Santa Coloma (2-0), sonte (e premte) do të përballlet në

finale me skuadrën e Lincoln Reds Imps nga Gjibraltari. Kjo e fundit e ka mposhtur në gjysmëfinale skuadrën e La Fiorita (2-0). Gjilanasit edhe në këtë ndeshje do të luajnë për fitore. Drita është

kampione e Kosovës, kurse për herë të parë merr pjesë në garat ndërkombëtare, derisa kundërshtari Lincoln Reds Imps është kampion në vendin e vet dhe për herë të parë ka marrë pjesë në

garat e Ligës së Kampionëve në vitin 2014. Ndeshja zhvillohet në stadiumin "Victoria" nga ora 20:30, kurse skuadra fituese do të përballlet me pas me kampionen e Suedisë, Malmon.



Prishtina barazon ndaj FC Europas

Prishtinë, 28 qershor - Skuadra fituese e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina e ka nisur me barazim aventurën në Ligën e Evropës.

Skuadra kryeqytetase e Kosovës luajti 1-1 ndaj Europa FC. Të parët shënuan vendasit në fundit të pjesës së parë nga penalltia, autor i

golit ishte Carrenos. Në pjesën e dytë Prishtina barazoi shifrat me një supergol nga gjuajtja e lirë të Meriton Korenicës, i cili realizoi pesë

minuta pasi filloi pjesa e dytë. Më 5 korrik Prishtina e pret në shtëpi klubin nga Gjibraltari, për të zhvilluar ndeshjen e kthimit.



Kolumbia e para, Japonia kualifikohet falë 'fair-play'-të



MOSKE, 28 QERSHOR - Situata në Grupin H ishte dramatike për faktin se tri ekipe luanin për dy vende kualifikuese. Përveç polakëve që e kishin prerë biletën e kthimit, Kolumbia, Senegali dhe Japonia ishin në luftë për të kaluar në fazën e 1/8-ave. Pas pjesëve të para që përfunduan me rezultatin 0-0 në të dyja ndeshjet, pjesët e dyta pritëshin të kishin emociione të mëdha. Kolumbia

detyrohet të luajë pa James Rodriguezin, i cili largohet nga fusha i lënduar pas gjysmë ore lojë. Ndërkohë surpriza vjen në ndeshjen e Japonisë, ku polakët kalojnë në avantazh në minutën e 60 falë golit të Bednarekit. Japonezët hidhen në sulm për ta gjetur golin e avantazhit që do t'i shpëtonte kur kolumbianët gjejnë golin e avantazhit në minutën e 74-t. Ishte talenti i Barcelonës, Yerry

Mina, ai që shënoi pas një tjetër goditjeje këndore. Me atë rezultat, Senegali rrezikonte eliminimin për shkak se Japonia kishte më pak kartonë të verdhë. Japonia dhe Senegali kanë nga katër pikë dhe po aq gola të shënuar, kështu që skuadra më "fair-play" kalon në fazën tjetër. Nuk kishte ndryshime rezultati deri në fund të takimit. Kolumbia dhe Japonia kalojnë në fazën e 1/8-ave.

Raikkoneni te McLaren nëse largohet Alonso

LONDËR, 28 QERSHOR - Në rast se Fernando Alonso do të largohet nga makina McLaren në fund të këtij sezoni, vendin e tij mund ta zërë një tjetër pilot me përvojë në Formula 1, finlandezi Kimi Raikkonen. Lajmin e ka konfirmuar "Sky Sports", që thotë se finlandezi i Ferrarit do të jetë i lirë në fund të sezonit dhe ka nisur bisedimet me makinën britanike për ta pilotuar në vitin 2019. Por, gjithçka do të varet nga spanjulli Alonso, nëse do të pilotojë edhe sezonin e ardhshëm apo jo. Alonso ka deklaruar se nuk do të marrë asnjë vendim për të ardhmen deri në gusht të këtij viti, ndërkohë që McLaren po përpiqet t'i mbushë mendjen të qëndrojë edhe sezonin tjetër. "Ne nuk kemi nisur ende bisedimet dhe kjo është një çështje që do ta diskutojmë më vonë", ka thënë Zak Brown, shefi i McLaren. Duket se i sig-



urt do të jetë Stofel Vandoorne, ndërsa piloti tjetër do të jetë me

përvojë, ndaj McLaren synon ta marrë Raikkonenin, 38-vjeçar.

SHKURT / "RUSI 2018"

De Biasi, kandidat për stolin e Polonisë

Gianni de Biasi është një nga kandidatët kryesor për ta marrë drejtimin e përfaqësueses së Polonisë. Trajneri aktual i polakëve, Adam Nawalka, pritet të largohet sapo ta mbyllë aventurën në Botëror dhe, sipas shtypit vendës, pasuesi i tij mund të jetë një mes Jacek Magieras (trajneri aktual i U-20), Michal Probiez të Krakovias dhe ish-trajnerit të Shqipërisë. De Biasi është pa punë që pas shkarkimit nga drejtimi i Alaves në Spanjë dhe gjithmonë është shprehur se dëshiron ta marrë drejtimin e një skuadre ku të jetë në qendër të projektit. Me zhgënjimin e Polonisë në Botëror, drejtuesit e Federatës Polake të Futbollit mund t'ia besojnë drejtimin pikërisht 61-vjeçarit, që ka përvojën e duhur në krye të Shqipërisë, duke i kualifikuar kuqezinjët në "Euro 2016".

D'Antoni te Houstoni deri në 2020-n

